



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË / OMBUDSMAN'S OFFICE FOR PREKRŠAJE U PRIŠTINU/ MUNICIPAL
 MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj.24895/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Halit Kamer Zymeri nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6.parg.2 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.14.10.2011 merrë këtë,

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Halit Kamer Zymeri i lindur me 23.07.1949 në Uçë K.Istogut, tani jeton në Rr"Lot Vaku"nr.659, i martuar, babë i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Fakultetin e Mjekësisë të kryer, Drejtor qendres diagnostike-radiologjike në Prishtinë.

Ë s h t ë p ë r g j e g j e s

Sepse si Drejtor i Qendres Diagnostike Radiologjike në QKU-në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatine caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njohtuar se është përfshirë në listen e Zyrtarve të Qendres Klinike Univerzitare, të cilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë.

Me veprim të këtill ka kryer kundërvajtje nga neni 6 pika.2. lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në të holla në shumë prej **800 (tetëqind)** Euro, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës, në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do ti zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur. Në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit, kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën nr.01-3230/11 të parashtruar gjykatës me datën 19.07.2011 për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendur me lartë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndegjuar të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: Është e vertet se jo vetëm për vitin 2011, por asnjëher nga unë nuk është kërkuar, nga kur jam Drejtor i Qendres Diagnostike-Radiologjike, ta bejë deklarin e pasurisë, dhe askush nuk më ka lajmruar dhe nuk më ka siell kurrfar formularësh se jam i obliguar që ta bejë deklarin e pasurisë.

Për sqarimin edhe ma mirë të kësaj qështje gjykata thirri në cilësin e deshmitarit U.D. të Drejtorit të QKU-së Lulëzim Eminin i cili tha se të gjith zyrtarët që kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë i kemi

2.

njohtuar më kohë,perms sekretarës Razija Abazi e cila paraprakisht ka qenë e informuar nga shefi i shërbimit Skender Shabani. Të njejtëve u është treguar edhe adresa në VEB faqe. Sot unë ja parashtroj të gjitha provat gjykatës mbi informimin e zyrtarve të lartë.

Gjykata pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, deshmisë së deshitarit, provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës erdhi në përfundim se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshën e kundërvajtjes, dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe renduese.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Me sa u tha me lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari

Murat Paçarada